

DOKU FEST

International Documentary
and Short Film Festival



2024

Jemi mirënjohës dhe krenarë që ndajmë raportin vjetor të këtij viti për DokuFest. Falë mbështetjes suaj, kemi festuar edhe një vit të jashtëzakonshëm të kreativitetit dhe lidhjes, duke bashkuar audiencë të larmishme, artistë dhe inovatorë.

Faleminderit që jeni pjesë e këtij rrugëtimi. Jemi të emocionuar të vazhdojmë të inspirojmë dhe festojmë në vitin që vjen.

RAPORTI VJETOR

EDICIONI XXIII

2-10 GUSHT 2024

PRIZREN, KOSOVA

RAPORTI I FESTIVALIT

A photograph of a gallery space. In the foreground, a man with a backpack is seen from the back, looking towards a wall display. Other people are visible in the background, some looking at the wall. The lighting is soft and focused on the display.

246 Filma

66 Shtete

7 DokuTalks

3 Masterklasa

9 Punëtori

A photograph of a crowded outdoor event at night. People are gathered in front of a building. Several German flags are visible, held by people. The scene is illuminated by streetlights and building lights.

11 Ngjarje muzikore

9 Ekspozita

15.355 Pjesëmarrës

108 Pjesëtarë të personelit

119 Vullnetarë

PËRMBLEDHJE

Edicioni i 23-të i DokuFest-it u mbajt në Prizren nga data 2 deri më 10 gusht 2024. Në programin e këtij viti u shfaqën 246 filma, u organizuan 7 DokuTalks debate, 3 masterklasa, 9 punëtori, 9 ekspozita dhe 11 shfaqje muzikore "live" që mbledhën kineastë, artistë dhe audiencë nga Kosova, rajoni dhe mbarë bota.

Në gjithësej aplikuan 3,325 filma nga 119 shtete të ndryshme, dhe nga ky numër ekipi ynë i programit përzgjedhi me kujdes 103 filma për të konkurruar në tetë kategori garuese, dhe 143 filma të tjerë në 13 programe të kuruara me kujdes të veçantë. Gjatë këtij edicioni, një numër i madh filmash patën premierat e tyre botërore, ndërkombëtare dhe evropiane, duke e forcuar kështu edhe më tej rolin e DokuFest-it si një hapësirë për promovim të zërave të rinj dhe shfaqje të historive me mesazhe të fuqishme. Në këtë drejtim, DokuFest-i vazhdon të jetë një platformë domethënëse për kinemanë inovative, duke u përpjekur të bëjë një përzgjedhje të larmishme të filmave dokumentarë dhe narrativa që sfidojnë traditat dhe zgjojnë debate.

Çdo vit DokuFest-i përzgjedh një temë që pasqyron shqetësimet që kërkojnë vëmendje urgjente të shoqërisë. Tema e këtij viti, "NEW ORDER" (Rendi i Ri), u fokusua në ndryshimet e mëdha që po ndodhin sot në mbarë botën, siç janë tensionet gjeopolitike, krizat mjedisore dhe pabarazia në shpërndarjen e pasurisë, duke nxitur kështu diskutime kuptimplota rreth shqetësimeve të përbashkëta njerëzore.

Hendeku midis të pasurve dhe të varfërve, duke përfshirë edhe konfliktet, si luftërat në Gazë dhe Ukrainë, sugjerojnë se polet e sistemit ndërkombëtar mund të jenë duke u zhvendosur. Faktorë të tjerë, si rritja e ekonomisë globale të pjesës jugore të globit, veprimet ushtarake të Rusisë dhe sfidat ekonomike nga Kina, janë dëshmi e ndryshimeve të mëdha të mundshme.

Me anë të përzgjedhjeve të filmave dhe diskutimeve mbi këto tema urgjente e të rëndësishme të kohës, festivali kishte synim të eksplorojë nëse po e prekim fundin e rendit të vjetër botëror dhe fillimin e një të riu.

Shprehim mirënjohje të sinqertë për sponsorët, partnerët, ekipin, vullnetarët dhe kineastët tanë që e bënë të mundur realizimin e festivalit edhe këtë vit. Bashkohuni me ne përsëri vitin e ardhshëm, gjersa vazhdojmë të eksplorojmë fuqinë transformuese të filmit.



PROGRAMMI | FILMIT

NEW ORDER

:DOKU
FEST

WINNERS

FITUESIT



BALKAN DOX FITUES

Another Day

nga Eneos Çarka

INT'L FEASURE DOX FITUES

A Fidai Film

nga Kamal Aljafari

INT'L SHORT DOX FITUES

History is Written at Night

nga Alejandro Alonso Estrella

INTERNATIONAL SHORTS FITUES

The Death of a Hero

nga Karin Franz Körlof

HUMAN RIGHTS DOX FITUES

Silence of Reason

nga Kumjana Novakova

GREEN DOX FITUES

Apple Cider Vinegar

nga Sofie Benoot

TRUTH DOX FITUES

23 Mile

nga Mitch McCabe

NATIONAL FILM FITUES

Like a Sick Yellow

nga Norika Sefa

AUDIENCE AWARD FITUES

Afterwar

nga Birgitte Stærmose

TALENT DOC AWARD FITUES

Workers' Wings

nga Ilir Hasanaj

DISTRIBUTION AWARD FITUES

reMemBer2.human

nga Durim Klaiqi

PROGRAMI GARUES

Si gjithmonë, kategoritë garuese ishin në qendër të kurimit tonë dhe përzgjedhjet e këtij viti ishin mbresëlënëse si kurrë më parë. Filmat e paraqitur në kategorinë e garës **Balkan Dox** vënë në pah kërkimin tonë njëvjeçar për dokumentarët më të mirë nga rajoni, duke ofruar një vështrim të larmishëm të prodhimit si në stil ashtu edhe në përmbajtje.

Kategoria garuese **International Feature Dox** për filma të metrazhit të gjatë dhe të shkurtër, ishte një vend zbulimi si për ne ashtu edhe për audiencën tonë. Vazhduam ta vëmë theksin tek të drejtat e njeriut dhe çështjet mjedisore në kategoritë garuese të të **Drejtave të Njeriut** dhe **Green Dox**, duke shfaqur filma me tematikë mbi disa nga temat më urgjente të kohës sonë.

Në kategorinë e filmave të shkurtër u prezantuan disa nga filmat më të mirë të shkurtër, duke përfshirë filma nga festivalet kryesore të filmit dhe disa premiera botërore, një fakt që na mbushi me krenari. “**Truth Dox Competition**” u fokusua në histori personale dhe globale që eksplorojnë nocionin e së vërtetës.

Në kategorinë e **Garës Kombëtare** shfaqëm një listë po aq mbresëlënëse, me filma fitues çmimesh në festivale të mëdha përpara shfaqjes së tyre në festivalin tonë. Me 14 filma në konkurrim, nuk është aspak e tepërt ta quajmë një nga vitet më të mira në historinë e filmit të Kosovës.

PROGRAME TË VEÇANTA

VIEW FROM THE WORLD

DokuFest-i prezantoi një përzgjedhje prej 10 filmash të guximshëm jo-fiksion (të bazuar në ngjarje të vërteta) në shtandin e tij të njohur View From the World, duke shfaqur disa nga veprat më kuptimplote politike të vitit. Ndër kryesorët ishin No Other Land, Soundtrack to a Coup D'Etat dhe Direct Action, një grup prej tre filmash që trajtojnë çështje politike urgjente të kohës. Në program gjithashtu u përfshinë dy premiera të Festivalit të Filmit në Kanë: Lula, nga Oliver Stone, i cili eksploron jetën e presidentit brazilian Luiz Inácio Lula da Silva, dhe The Falling Sky nga Eryk Rocha dhe Gabriela Carneiro da Cunha, i cili fliste rreth komunitetit indigjen Watorikí në Brazil. Obscure Night - Goodbye Here, Anywhere nga Sylvain George, i cili trajtoi në thellësi gjendjen e vështirë të emigrantëve afrikanë në Marok, i shtoi edhe më shumë vlerë fokusit të kategorisë mbi çështjet urgjente globale.


Kjo kategori u përmyll me disa filma tjerë të shquar, duke përfshirë këtu Hollywoodgate, i cili shqyrtoi ngritjen e talibanëve si një forcë ushtarake pas tërheqjes së SHBA-ve nga Afganistani, Copa 71, i cili fliste për një Kupë Botërore pak të njohur të Grave dhe Life and Other Problems, një vepër reflektuese nga Max Kestner. Gjithashtu u shfaq filmi I'm Not Everything I Want To Be i Klára Tasovská, një portret lëvizës i fotografit çek Libuše Jarcovjáková. Kjo përzgjedhje e larmishme shpërfaqti vitalitetin e krijimit të filmit dokumentar dhe angazhimin e këtyre kineastëve për të trajtuar tema të rëndësishme sociale dhe politike.

FOCUS UKRAINE

Në bashkëpunim me Docudays, prezantuan me krenari Focus Ukraine, një program shumë domethënës që tregon qëndrueshmërinë dhe kreativitetin e kinemasë dhe fotografisë dokumentare ukrainase. Mbështetur nga fondacioni IZOLYATSIA, Trans Europe Halles, dhe programi për rindërtim ZMINA, kjo ishte nisma më e madhe e DokuFest-it me fokus në një shtet deri më sot.

Në këtë përzgjedhje u paraqitën një seri prej 9 filmash të shkurtër dhe të metrazhit të gjatë që trajtojnë çështjet personale dhe shoqërore thelbësore për jetën ukrainase në mes të konfliktit, si trashëgimia e totalitarizmit sovjetik, rrëzimi i fluturimit 17 të Malaysia Airlines dhe qëndrueshmëria e përditshme e ukrainasve gjatë kohës së luftës.

Këta filma i mundësuan audiencës ta kuptojnë ndikimin e thellë të luftës së vazhdueshme në shoqërinë ukrainase si dhe t'i shohin nga afër sfidat e thella emocionale, kulturore dhe politike me të cilat po përballen njerëzit atje.



NO OTHER LAND: FILMS ON PALESTINE

Një tjetër program special i titulluar *No Other Land: Films on Palestine*, që ofroi një eksplorim në kohë dhe thelbësor të konfliktit palestinez-izraelit në mes të luftës së vazhdueshme në Gaza dhe tensioneve përshkallëzuese në Lindjen e Mesme. Programi synonte të hidhte dritë mbi rrënjët e konfliktit dhe pasojat e tij të gjera. Filmi artistik *Route 181: Fragments of a Journey in Palestine-Israel*, i kineastit palestinez Micha Kleifi dhe regjisorit izraelit Eyal Sivan, u dallua si një shqyrtim i thellë i marrëdhënieve komplekse midis dy kombeve që jetojnë në të njëjtën tokë. Dokumentari, i incizuar në vitin 2002, i çon shikuesit në një udhëtim çorientues përgjatë vijës së ndarjes së vitit 1947, duke ofruar një portretizim nga afër të trazirave të vazhdueshme të rajonit. Një vepër tjetër e rëndësishme, *No Other Land*, dokumentoi jetën në fshatin e pushtuar të Masafer Yatta, duke nënvizuar rezistencën kundër zhvendosjes së detyruar, ndërsa vinte në pah miqësinë e pamundur midis aktivistit palestinez Basel dhe gazetarit izraelit Yuval.

Në këtë program gjithashtu u shfaqën filmat *Three Promises*, një film thellësisht personal i përbërë nga video familjare që pasqyrojnë luftën e gjatë të Palestinës për liri, dhe *UNDR*, një film tjetër i shkurtër nga Kamal Aljafari, i cili përdori pamjet arkivore për të krijuar një rrëfim shqetësues rreth inkursioneve në Palestinë. *Man Number 4* i Miranda Pennell ofroi një reflektim rrëqethës mbi natyrën soditëse të dëshmisë së konfliktit përmes një fotografie nga Gaza, ndërsa *Dancing With Palestine* paraqiti traditën palestineze të dabke si një formë e rezistencës kulturore.

1974: THEN IS NOW

Viti 1974 konsiderohet gjerësisht si një nga më të rëndësishmit në historinë e kinemasë, me shfaqjen e kryeveprave nga regjisorë të mirënjohur si Coppola, Cassavetes, Scorsese, Altman, Rivette dhe të tjerë. Gjersa kjo mund të thuhet për filmat dokumentarë të shfaqur atë vit, një rrëfim edhe më bindës shfaqet kur mbi këta dokumentarë reflektohet pesëdhjetë vjet më vonë. Këta filma të vitit 1974, që trajtojnë politikën, pushtetin, seksualitetin dhe estetikën, rezonojnë jashtëzakonisht me çështjet bashkëkohore, duke ofruar pamje të hershme në narrativat me të cilat përballemi sot. Këta filma dokumentojnë konflikte të tilla si lufta izraelito-palentineze, luftën për barazi gjinore dhe seksuale, nocionet në zhvillim të pushtetit shtetëror dhe kritikën e sistemit të drejtësisë penale. Në programin “1974: Then is Now” u paraqitën njëmbëdhjetë filma të jashtëzakonshëm në katër programe tematike, duke i mundësuar audiencës të rishikojë dhe reflektojë mbi këto momente historike dhe lidhjen e tyre me realitetet aktuale.

Me shumë kënaqësi dhe emocion e paraqitëm “1974: Then is Now” në Prizren, një program i kuruar me finesë nga Eric Hynes, kurator i lartë i filmit në muzeun “Moving Image” në New York.

SPOTLIGHT: EDUARDO WILLIAMS

Regjisori argjentinas Eduardo “Teddy” Williams demonstroi një aftësi unike për të kapur jetën në mediat res, ku personazhet dhe grupet e të rinjve shpesh përjetojnë atë që duket si amnezi e përkohshme. Ky çorientim shpesh çon në ndërrime formash dhe transformime, duke i dërguar ata në realitete alternative që nuk janë domosdoshmërisht një vazhdimësi e përvojave të tyre të mëparshme. Megjithëse vendi apo momenti i mëparshëm mund të mos harrohet plotësisht, personazhet e Williams lundrojnë nëpër logjikën e tyre imagjinative, të shtyrë nga magjia krijuese e kinemasë së tij. Kjo lëvizje nëpër hapësirë, kohë dhe kultura të ndryshme ndihet jashtëzakonisht e gjallë, sikur të udhëhiqet nga harta të pa-eksploruara të imagjinatës.

Shpesh, duke e gjetur veten në supermarkete - një simbol i zgjedhjes dhe bollëkut - personazhet e tij mund të mos gjejnë gjithmonë atë që kërkojnë atje. Megjithatë, qoftë në një supermarket tjetër, në një çati, në një xhungël, në një rrugë të qytetit, në një dhomë bisede në rrjetet sociale apo mes miqsh, ata në fund zbulojnë një ndjenjë të afërsisë e bashkimit. DokuFest-i pati kënaqësinë për ta shfaqur punën e Williams në Prizren përmes një programi të veçantë ku u përfshin tre filma: *The Human Surge*, *The Human Surge 3*, dhe një koleksion prej pesë filmash të shkurtër të hershëm ku Williams eksperimentoi me video incizime të formateve dhe teksturave të ndryshme. Ky program, i kuruar nga kuratorja e ftuar Pamela Cohn, ofroi një mundësi të rrallë për të eksploruar botët dalluese të këtij regjisori novator dhe ambicioz.

PLEASURE HEADS MUST BURN: MUSIC ON FILM

DokuFest-i vazhdoi eksplorimin e muzikës dhe filmit me një program eklektik të titulluar *Pleasure Heads Must Burn: Films on Music*. Filmat kryesor përfshinë *Mutiny in Heaven: The Birthday Party* e Nick Cave, ku paraqitet lëvizja e grupit post-punk *The Birthday Party* nga Australia në Londër dhe *Mogwai: If the Stars Had a Sound*, përmes të cilit dokumentohet puna e grupit skocez në përgatitjen e albumit të tyre *As the Love Continues*, gjatë periudhës së pandemisë.

Programi paraqiti gjithashtu filmin *Ryuichi Sakamoto I Opus*, duke shfaqur performancën e fundit të Sakamoto-s në piano, dhe *Efterklang: The Makedonium Band*, ku paraqitet bashkëpunimi i grupit danez me muzikantët maqedonas në monumentin *Makedonium*, i pasuar nga një performancë live. Programi u përmbyll me paraqitjen e dy filmave për muzikën dhe lirinë: *HAIYU - Këngëtarja rebele Mariem Hassan* dhe *Dancing Palestine*.

TRIANGLE PROGRAM

Në këtë program u shfaqën tre filma, të kuruara nga festivale partnere, duke përfshirë BIEFF - Festivali Ndërkombëtar Eksperimental i Filmit në Bukuresht, Vienna Shorts dhe DokuFest. Programi u zhyt në emocionin e brishtë e të fortë të dëshirës për një realitet tjetër – duke kërkuar më shumë paqe, siguri, rregull dhe bukuri. Shfaqja e parë u bë në maj të vitit 2024 në Vienna Shorts dhe e treta do të ndodh në shtator në BIEFF në Bukuresht.

Projekti Triangle, një iniciativë nga Vienna Shorts, këtë vit iu kushtua temës *Longing for Political Stability* (Mall për Stabilitet Politik), duke u fokusuar në dëshirën universale për siguri dhe mungesën e frikës në lidhje me hapat, ditët apo zgjedhjet e ardhshme. Në një botë me peizazhe politike gjithnjë në ndryshim, kjo dëshirë për stabilitet rezonon thellë nëpër shoqëri. Projekti eksploroji mallin si një forcë shtytëse, njësoj si ajo e *Kieślowskit Talking Heads*, duke ngritur pyetjen: Çfarë duan njerëzit më së shuti nga jeta? Kjo temë u shtri në çështjet e përkatësisë, autonomisë, sigurisë politike dhe ndryshimeve shoqërore, duke shqyrtuar sesi malli formon aspiratat personale dhe kolektive.

SPECIAL SCREENINGS

Në prgramin Special Screenings u prezantuan katër filma. *Classified People* nga Yolande Zauberman, i xhiruar në mënyrë klandestine në 16 mm, ofroi një shembull të shkëlqyeshëm të krijimit të filmave dokumentarë radikalë. Ai ofroi një portretizim nga afër të asaj se si segregacioni i mbështetur nga shteti depërtoi thellë në jetën private të atyre që prekeshin nga ky fenomen. *Return to Kosovo*, me bashkë-regji nga Emma Strauss, Julius Strauss, Donald Harding dhe Ben Harding. 20 vjet pas mizorive, Julius mori një mesazh nga Besniku, një i mbijetuar i masakrës. Filmi ishte një reflektim emocionues mbi kujtesën dhe qëndrueshmërinë.

Premiera kombëtare e filmit *“On the Way”* nga Samir Karahoda shërbeu si filmi përmbyllës i edicionit. Gjithashtu, Ansambli Eksperimental Lumbardhi dha një performancë unike duke shoqëruar filmin dokumentar *The Wrestlers (1975)* të Besim Sahatçiu. Ky projekt, i drejtuar nga Ilir Bajri, shfaqti shprehje të reja zanore të krijuara gjatë një punëtorie një javore me muzikantët pjesëmarrës. Performanca ndërthuri reflektime muzikore me trashëgiminë historike dhe kulturore të garave tradicionale të mundjes në Gorë dhe Opojë, dhe u bë me porosi nga Fondacioni Lumbardhi.



ARE YOU UP FOR ADVENTURE?

Pasta
FASTA

SHE

ODE TO CELLULOID: FILMS ON FILM

Në përputhje me eksplorimin e gjatë të kinemasë, historinë dhe përfaqësimin e saj, festivali paraqiti tre dokumentarë të jashtëzakonshëm me metrazh të gjatë, secili duke pasqyruar një pasion të përbashkët për ruajtjen e filmit.

Ehsan Khoshtbakht Celluloid Underground e prezantoi Ahmad Jorghanian, një koleksionist iranian filmash që të kujton Henri Langlois, koleksioni i madh i të cilit prej mbi 5,000 printimesh dhe posterash ishte fshehur në të gjithë Teheranin, duke sfiduar ndalimin e vendit për filmat perëndimor. Dokumentari shfaqti përpjekjet e palodhura të Ehsanit dhe Ahmedit për të shpëtuar këta filma, duke festuar kinemanë dhe miqësinë e tyre unike. Filmi i Peter Flynn Film is Dead. Long Live the Film! bëri homazhe për koleksionistët e përkushtuar për shpëtimin e filmave nga errësira, ndërsa bashkëpunimi në mes të Matevž Jerman dhe Jurij Meden zbuloi një thesar të kinemasë avangarde dhe eksperimentale sllovene, duke përmbyllur këtë përzgjedhje të jashtëzakonshme.

Red Bull

PLUGOVE

BLAST FROM THE PAST

Edhe një herë, u kthym në historinë e kinemasë sonë të dashur Lumbardhi, duke sjellë një pjesë të vogël të asaj që ishte shfaqur atje në të kaluarën. Në bashkëpunim të ngushtë me Fondacionin Lumbardhi, nën titullin Blast from the Past, shfaqëm tre filma të jashtëzakonshëm nga të mëdhenjtë e kinemasë Federico Fellini, Stanley Kubrick dhe Wim Wenders.

Prezantim special: Soundwalk Collective & Patti Smith Correspondences (Screening)

CORRESPONDENCES ishte një projekt në zhvillim midis Soundwalk Collective dhe Patti Smith, që shtrihet mbi një dekadë dhe përshkoi gjeografi dhe mjedise të ndryshme natyrore. Artistët zbuluan gjurmë zanore të lëna nga poetë, kineastë, revolucionarë dhe ndikimin e ndryshimeve klimatike. Stephan Crasneanski, themeluesi i Soundwalk Collective, eksploroj dhe kapi tingujt e disa prej vendeve më të largëta të botës, duke kërkuar të zgjojë një kujtesë zanore brenda peizazheve dhe të zbulojë historitë e së shkuarës dhe të tashmes të botës sonë.

Kompozimet që rezultuan pasqyruan marrëdhëniet njerëzore me mjedisin, ekzistencën dhe procesin krijues. Fillimisht i konceptuar si udhëtim i gjatë zanor, Stephan ndau këto incizime me Patti Smith, duke i ofruar asaj peizazhe të reja zanore për të frymëzuar vizionin e saj poetik. Bashkëpunimi i tyre, i cili filloi me një takim të rastësishëm në një avion, u rrit përmes korrespondencës së vazhdueshme, duke i lejuar ata të reflektojnë mbi jetën dhe natyrën. Për CORRESPONDENCES, ata krijuan tetë pjesë që përmbysnin marrëdhënien tradicionale midis tingullit dhe imazhit - tingulli ishte i pari dhe elementët vizualë u redaktuan më vonë për të shoqëruar muzikën. Veprat përfshinin tema nga ndërhyrja njerëzore në oqeanë, qëndrueshmëria e natyrës pas Çernobilit, tek shoqëritë e decentralizuara të parashikuara nga Kropotkin dhe nata e fundit e Pasolinit, duke formuar përvoja audiovizuale që nxisin mendime.

90

FUTURE IS HERE + NEW WAVE + FOREST OF FRAMES

Për më shumë se një dekadë, shkolla e filmit "The Future is Here" ka qenë një gur themel i misionit të DokuFest-it për të fuqizuar zërat e rinj në Kosovë. Kjo nismë ka ofruar një hapësirë për vetë-shprehje, aftësi për të bërë filma dhe udhëzim në krijimin e dokumentarëve rrëfyes bindës. Tani në edicionin e tij të 12-të, programi, i mbështetur nga National Endowment for Democracy, vazhdon të formësojë të ardhmen e kinemasë së Kosovës, veçanërisht në fusha si montazhi, dizajni i zërit dhe post-produksioni, ku mundësitë janë të kufizuara. Tetë dokumentarë të rinj të shkurtër u shfaqën më 6 gusht gjatë Ditës së Talentit në DokuFest, një dëshmi e përkushtimit dhe pasionit të studentëve nën mentorimin e Dea Gjinovci, Leart Rama dhe Eroll Bilibani. Punëtoritë e redaktimit, të udhëhequra nga mentorët e diplomuar Trendeline Halili, Flutura Balaj dhe Hana Ahmeti, i kanë lustruar filmat më tej, ndërsa masterklasat nga kineastët si Andrijana Stojkoviç, Samir Karahoda dhe Norika Sefa e kanë pasuruar edhe më tej procesin kreativ.



91



DOKUNIGHTS

Edicioni i këtij viti bëri që DokuNights të evoluojë në një format të ri, duke u shndërruar në një përfaqim muzikor në tërë qytetin, me tri skena të veçanta ku u paraqitën akte muzikore që shtynë kufijtë e eksplorimit të zërit. Kuruar nga Nita Deda dhe Leart Rama, përzgjedhja përfshinte një sërë stilesh të ndryshme muzikore, duke filluar nga këngët ceremoniale shekullore e deri te aktet bashkëkohore me qasje moderne ndaj tingullit.

Shfaqjet e shquara përfshinin një koncert nga grupi palestinez i muzikës shamstep 47 Soul, një performancë specifike e krijuar nga Tiran Willemse dhe Nkisi për DokuFest, një natë e magjepsëse në kala e organizuar nga labeli/grupi me ndikim nga Berlina Hypersoft, i paraprirë nga një shfaqje kinematografike live nga Gianmarco.

Agona Shporta nga Prizrenit lansoi albumin e saj debutues në vendlindjen e saj me një grup të mirënjohur muzikantësh xhaz, ndërsa producentja e muzikës elektronike nga Prishtina, Eljesa Beka publikoi një album thellësisht personal, i ndjekur nga një performancë kuadrofonike live nga legjenda e muzikës finlandeze Aleks Perälä. Herrensauna u rikthye në DokuFest me një performancë të veçantë me kompozime tingujsh halucinante dhe këngë të shenjta sufiste nga Gegezen, ndërsa grupi danez pop, indie-rock, post-rock dhe elektronik Eterklang paraqiti një film dhe një koncert në kinemanë ikonike të Lumbardhit.

Festivali u hap me paraqitjen e artistes spirituale Aisha Devi, e cila performoi krijimin e saj të ri vizual dhe muzikor Les Immortelles, dhe u mbyll me një koncert nga Orkestra e Shkodrës, duke festuar trashëgiminë e pasur të Shkodrës në veri të Shqipërisë dhe shpirtin artistik të një qyteti ku të gjithë këndojnë.

DOKUPHOTO

DokuFest i bashkoi forcat me DocudaysUA për të vënë në pah kinemanë dokumentare ukrainase dhe fotografinë përmes Focus Ukraine në DokuFest në Kosovë. Ky partneritet mundësoi krijimin e ekspozitës më të madhe të festivalit deri më sot, duke theksuar qëndrueshmërinë dhe kreativitetin e kulturës ukrainase.

DokuPhoto, ekspozita fotografike shoqëruese për Focus Ukraine në DokuFest, shfaqti fotografi me ndikim nga artistë ukrainas. Ekspozita e sivjetme DokuPhoto prezantoi punën domethënëse dhe intime të fotografit ukrainas Mykhaylo Palinchak, i cili u zhyt thellë në jetët dhe peizazhet e atdheut të tij të shkatërruar nga lufta. Ekspozita ofroi një dritare në rezistencën personale dhe të përbashkët që përcaktoi historinë bashkëkohore të luftës në Ukrainë.

Ekspozita u kurua nga Sasha Nabieva, kuratore e Interdisciplinary Art Lab: Docu/synthesis x Arkivi i Luftës së Ukrainës në emër të DocudaysUA, dhe Ferdi Limani në emër të DokuFest.

Projekti Focus Ukraine u zbatua nga DokuFest Kosova dhe Docudays UA me mbështetjen e fondacionit IZOLYATSIA, Trans Europe Halles dhe Malý Berlin, dhe u bashkëfinancua nga programi për rindërtim ZMINA, i krijuar me mbështetjen e Bashkimit Evropian nën një thirrje të dedikuar për të ndihmuar njerëzit e zhvendosur ukrainas dhe sektorët kulturorë dhe krijues ukrainas.

DOKUTALKS

DokuTalks shërbeu si një lidhje e gjallë për profesionistët e filmit, aktivistët dhe studiuesit, duke nxitur një shkëmbim të pasur idesh dhe përvojash. Kuruar nga Eroll Bilibani dhe Dea Gjinovci, DokuTalks-i i këtij viti paraqiti 7 panele diskutimesh nxitëse, 3 masterklasa të punës praktike dhe 9 ekspozita tërheqëse, të gjitha të përqendruara në fuqinë e kinemasë për të frymëzuar ndryshimin dhe adresimin e çështjeve globale.

Panelet e diskutimit dhe masterklasat eksploruan ndërthurjen e tregimit me çështje urgjente të kohës siç janë ndryshimi i klimës, ruajtja e arkivave në zonat e konfliktit dhe roli në zhvillim i festivaleve të filmit në një epokë post-COVID. Diskutimet theksuan lidhjet e thella midis komuniteteve dhe mjedisëve të tyre, sfidat më të cilat përballen arkivistët në ruajtjen e historisë dhe rëndësinë e besimit dhe bashkëpunimit në krijimin e filmave. Kjo seri ngjarjesh dinamike theksoi se si tregimet, përpiqjet arkivore dhe praktikat bashkëpunuese janë thelbësore për kujtesën kulturore dhe qëndrueshmërinë.

MASTERKLASA

Master Class - Birgitte Stærmose

Afterwar u incizua për gjatë një periudhe 15 vjeçare duke përdorur një përzierje të tregimeve dokumentare dhe imagjinare për të krijuar një ndjenjë të lartë të realitetit dhe një tregim më bindës. Filmi, i bashkë krijuar me kastin kryesor, përdori intervista kërkimore si bazë për të shkruar skenarin imagjinar, duke u fokusuar në historinë e brendshme dhe jo në ngjarje faktike. Në këtë Master Class, drejtoresha Birgitte Stærmose e zbuloi procesin dhe metodën e përdorur në film.

Në bashkëbisedim me Eduardo Teddy Williams

Pasi ishte në qendër të vëmendjes këtë vit në DokuFest, artisti Teddy Williams, na u bashkëngjiti për një bisedë të thellë të mërkurën, më 7 gusht, nga ora 15:00 deri në 16:30 në kafenenë De Still. Biseda, e moderuar nga Pamela Cohn, u përqendrua në qasjen unike të Williams ndaj tregimit kinematografik.

Master Klasa - Sylvain George

Në këtë Masterklasë u shqyrtua sesi demokracitë moderne mund të gjykohen nga fuqia e tyre për t'i bërë gjërat të shfaqen ose zhduken, duke u fokusuar në "ekspozimin", "nën ekspozimin" dhe "mbi ekspozimin". Duke përdorur njohuri nga Walter Benjamin, Donna Haraway dhe shembuj të ndryshëm kinematografikë, sesioni eksploroji mënyra estetike dhe politike që sfidojnë kufijtë e pranuar dhe adresojnë nevojat urgjente të përshkruara nga Frantz Fanon si "festa të imagjinatës".

EKSPOZITAT

“Hands on the Archives: War Destruction, Collective Documenting, and Technologies of War Representations” eksploroj dokumente arkivore - fotografi, video dhe tekste nga koha e luftërave jugosllave - në kontekste të ndryshme akademike, arsimore, arkitekturore dhe artistike.

“Connecting Dots: Exploring Shared Film Heritage”, një nismë bashkëpunuese nga DokuFest dhe Beldocs, e mbështetur nga projekti i BE-së “Kultura dhe Kreativiteti për Ballkanin Perëndimor”, shfaqti aktivitetet kërkimore praktike nga programet e vendeve përkatëse mbi arkivat e filmit jugosllav, revistat, gazetat dhe kinemanë bashkëkohore të Kosovës.

GALERIA 17 VR TOUR ofroi një përvojë virtuale 360° të dhjetë ekspozitave të ndryshme nga data 3 deri më 5 gusht, nga ora 13:00 deri në 18:00 në DokuCaffe. Vizitorët përdorën syze VR për të eksploruar vepra nga artistë vendas dhe ndërkombëtarë, duke përfshirë ekspozita të kuruara nga Natalija Vujošević, Blerta Hoçia, Fitore Isufi-Shukriu dhe Ana Frangovska, dhe hulumtuan tema nga “Vizioni Babilonas” tek “Horizonti i Dukshmerisë”.

KAOS CAMPING, një grup arti hungarez, përformoi duke përdorur filma super 8mm dhe 16mm, duke krijuar një përvojë të veçantë shqisore përmes kinemasë së zgjeruar.

DwP Corner nga E Drejta Humanitare Kosovë prezantoi “Teatrin Ilegal” nga Sovran Nrecaj, një dokumentar mbi sistemin paralel të arsimit dhe kulturës në Kosovë në vitet 1990. Video-dokumentari u shfaq në tenda me ngjyra të ndezura, që të kujtojnë hapësirat e improvizuara të performancës përgjatë asaj epoke.

The Threshold Turn, kuruar nga Leart Rama për DokuFest-in, shfaqti ekspozitën zhytëse të Mauro Ventura (Dj Saliva) së bashku me terapinë me dritë nga Soma_Light_Therapy. Skulptura e ngjashme me portën e Venturës e ndau hapësirën në një zonë të qetë terapie me dritë dhe një eksplorim simbolik të tranzicioneve dhe kufijve.

“STORIES WE TELL”, ekspozita e dytë e kampit në DokuFest, shfaqti video intervista të pjesëmarrësve të rinj nga të gjitha komunitetet anembanë Kosovës duke reflektuar mbi rritjen personale dhe perspektivat në zhvillim. Këto dëshmi zbuluan ndikimin e angazhimit me bashkëmoshatarë të ndryshëm në sfidimin e stereotipave dhe promovimin e respektit të ndërsjellë.

Ekspozita e Goran Djordjević-it në Pykë-Presje shfaqti vepra më pak të njohura në qytetin e tij të lindjes, Prizren. Ai paraqiti vepra grafike të vitit 1975 nga *Processes in a Square System*, filma eksperimentale të mesit të viteve shtatëdhjetë si *The Open Book* dhe *Family Photos*, dhe një film 30-minutësh me portrete 15 sekondëshe të mbi 100 artistëve, përfshirë Joseph Beuys dhe Marina Abramović, të shfaqura për herë të parë publikisht.

SHTANDI “I Can’t Sleep at Night”

Duke u rikthyer në zemrën e qytetit edhe për një vit tjetër, shtandi vjetor, i titulluar “I Can’t Sleep at Night”, priti vizitorët në një hapësirë të krijuar për reflektim. Duke hyrë brenda, të ftuarit gjetën një ditar të madh në pritje, duke i ftuar ata të lënë gjurmë përmes shënimeve të shkurtra, poezive, tregimeve ose reflektimeve personale.

Vizitorët u inkurajuan të shprehin lirish mendimet dhe emocionet e tyre. Çdo ditë, shënimet mbledheshin, skanoheshin dhe postoheshin në internet, me plane për t’i shfaqur përfundimisht ato rreth shtandit. Ky shtand u hap më 3 gusht dhe mbeti i qasshëm gjatë gjithë festivalit.

DOKUKIDS

Gjatë këtij edicioni, DokuKids ofroi një sërë punëtorish të ndryshme dhe edukative për të rinjtë, me çrast mblodhi në një vend rreth 300 të rinj. Këto punëtori u kuruan me kujdes nga Malborë Krajku dhe Idriz Morina.

U shfaqën 50 filma dhe u organizuan 9 seminare, duke ofruar një përzjerje të teorisë dhe praktikës që u mundësoi fëmijëve të moshës 7-11 vjeçare të mësojnë teknika dhe të zhvillojnë aftësi në fusha të ndryshme nën drejtimin e ekspertëve dhe artistëve të njohur. Filmat janë shfaqur çdo ditë në Parkun e Trajnimit dhe Inovacionit (ITP), me seminare që mbulonin tema si shkencë e të dhënave dhe inteligjencën artificiale (IA), shfaqje të videove të drejtpërdrejta, filmi 35 mm, arti ekologjik, animacioni stop-motion, joga, bërja e filmave me celular dhe robotika. Secila punëtori ofroi një përvojë praktike të të mësuarit, duke nxitur kreativitetin dhe njohuritë tek pjesëmarrësit e rinj.

Punëtoritë u organizuan në bashkëpunim me partnerë të ndryshëm, duke përfshirë IPKO, IPKO Foundation dhe Cactus Education.

Programi DokuKids u mundësua me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Kosovë.

DONATORËT

Rritja e festivalit, duke e bërë atë ngjarjen më të madhe në Kosovë dhe ndër më të rëndësishmet në rajon, është bërë falë mbështetjes së vazhdueshme të partnerëve dhe mbështetësve tanë afatgjatë.


DokuFest financohet nga organizata ndërkombëtare, institucione shtetërore dhe vendore, ambasada të huaja në Kosovë dhe sponsorët komercialë. U jemi shumë mirënjohës për mbështetjen, atyre që u ribashkuan me ne, madje e shtuan mbështetjen e tyre si dhe partnerëve të rinj që na u bashkëngjitën për herë të parë këtë vit.

E vlerësojmë shumë besimin e tyre në kauzën tonë. Do të vazhdojmë të punojmë shumë për ta bërë festivalin edhe më magjik dhe një sukses edhe më të madh çdo vit e më shumë.

Founding Partners



Principal Partners



Sustainable Partners



Media Sponsor



Supporters & Sponsors








DOKULAB

**DEPARTAMENTI ARSIMORI
DOKUFEST**





DokuLab, departamenti arsimor i DokuFest-it, fuqizon të rinjtë përmes filmit dhe tregimit, duke kombinuar mjetet audiovizive me metodat tradicionale. I fokusuar në nxitjen e ndërgjegjësimit social dhe të menduarit kritik, DokuLab ofron trajnime, punëtori dhe Qendrën e Prodhimit të Filmit për të mbështetur mësimdhënësit dhe për të frymëzuar zërat e rinj në fushën e kinematografisë.

Në vitin 2024, DokuLab, departamenti arsimor i DokuFest-it, vazhdoi të prijë në përparimin krijues dhe kulturor të Kosovës, duke u fokusuar në fuqizimin e zërave të rinj, mësimdhënësve dhe gjeneratës së ardhshme në tregimin kinematografik. Puna jonë përqendrohet në Qendrën e Prodhimit të Filmit për Rininë, ku nxënësit e shkollave të mesme marrin informata thelbësore, mentorim, frymëzim dhe një hapësirë mbështetëse për të krijuar tregime të bazuara në ngjarje reale. Ky mjedis edukues, nxit krijtjen e talentit krijues të vendit, duke nxitur një kulturë të pasur të tregimit kinematografik.

Bashkëpunëtorët e DokuLab e përforcojnë edhe më tej ndikimin tonë. Me mbështetjen financiare të Agjencisë Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida), ne do ta mbështesim dhe zgjerojmë peizazhin kulturor të Kosovës gjatë pesë viteve të ardhshme, duke ofruar mbështetje të paçmuar për iniciativat kreative. Një bashkëpunim i ri me Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) e vendos Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren si një qendër rajonale, e fokusuar në pajisjen e kineastëve të rinj dhe tregimtarëve dixhitalë me aftësitë e nevojshme për të shkëlqyer në epokën dixhitale.

Programi ynë vjetor i shkollës së filmit 'Future is Here', i angazhon 15 krijues të rinj në realizimin e filmave dokumentarë, duke trajtuar tema si të drejtat e njeriut, identiteti dhe ndryshimet klimatike. Këto tregime nxisin dialogun ndërkulturor, duke inkurajuar shprehjen e vetvetes dhe një ndërgjegjësim më të thellë për çështjet urgjente sociale.

Duke vazhduar me shtrirjen tonë arsimore, DokuLab integron edukimin filmik dhe multimedial në klasat në mbarë Kosovën, duke u ofruar mësimdhënësve burime që thellojnë të kuptuarit e nxënësve për përgjegjësitë sociale dhe mjedisore. I mbështetur nga National Endowment for Democracy, ky program përputhet me kurrikulën kombëtare të Kosovës, duke bashkuar artin dhe arsimin për të krijuar një përvojë kuptimplote të të mësuarit.

Nëpërmjet partneriteteve me UNICEF-in, ne gjithashtu do t'i pajisim të rinjtë nga 11 komuna me aftësi në fushën e tregimit, fotografisë dhe kinematografisë. Kjo iniciativë do të sjellë histori me ndikim dhe një dokumentar të shkurtër, duke vënë në pah potencialin transformues të tregimtarëve të rinj të Kosovës.

Qasja shumëdimensionale e DokuLab po ndërton një themel të qëndrueshëm për industrinë kreative të Kosovës, duke e pozicionuar gjeneratën e ardhshme në një pozitë të favorshme për të formuar një të ardhme më gjithëpërfshirëse dhe më të gjallë kulturore. Faqet e mëposhtme ofrojnë njohuri të detajuara për secilin projekt.

CREATIVE FORCE

MBËSHKETUR NGA AMBASADA SUEDEZE / AGJENCIA SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR
PERIUDHA KOHORE 2024-2028

Mbështetur nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (Sida) gjatë periudhës 2024 deri në 2028, programi i ri "Creative Force" i DokuFest-it është i dizajnuar për të forcuar industrinë kreative të Kosovës, për të promovuar zhvillimin e talenteve, për të përmirësuar barazinë gjinore dhe për të angazhuar komunitetet në dialogun shoqëror. Ky program e pozicionon DokuFest-in si lider në bashkimin e artit me ndryshimet sociale, veçanërisht përmes festivalit të filmit dhe departamentit arsimor, DokuLab.

Në synim të përsosmërisë kinematografike

DokuFest-i ka qenë prej kohësh më shumë se sa një festival filmi— ai simbolizon rilindjen kulturore të Kosovës pas konfliktit. Nën programin Creative Force, festivali synon të tërheqë një audiencë globale duke paraqitur dokumentarë të ndryshëm dhe filma të shkurtër që trajtojnë çështje kritike sociale dhe politike. Duke kuruar këtë përmbajtje të pasur e relevante ndërkombëtare, DokuFest-i aspiron ta ngritë Prizrenin në një qendër të rëndësishme për kinemanë dhe shkëmbimin kulturor, duke e vendosur atë si një platformë me ndikim për kineastët vendas dhe ndërkombëtarë.

Përmirësimi i edukimit përmes kinemasë

Dega arsimore e DokuFest-it, DokuLab, është e përkushtuar që të fus edukimin në fushën e filmit në shkollat anembanë Kosovës. Duke integruar filmimin dokumentar në klasa, DokuLab pajis studentët dhe mësuesit me mjete për shprehje krijuese dhe njohuri sociale. Bashkëpunimi me Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, ai premtion të krijojë një hapësirë të rëndësishme për kineastët e rinj dhe krijuesit aspirantë, duke nxitur rritjen në industrinë e filmit dhe rrjedhimisht duke ndihmuar në formimin e një brezi që kupton dhe vlerëson kinemanë si një mjet reflektimi shoqëror.

Vendosja e barazisë gjinore në rend të parë në kinema

Një ide kyçe e programit Creative Force është promovimi i barazisë gjinore brenda peizazhit filmik të Kosovës. Angazhimi i DokuFest-it për të përfunduar zërat e femrave dhe për të shfaqur tregimet e grave ofron si shikueshmëri ashtu dhe mbështetje për gratë në film. Nëpërmjet mentorimit dhe burimeve të synuara, DokuFest po punon për të shpërbërë stereotipet dhe për të fuqizuar kineastet femra. Kjo përpjekje shtrihet përtej programit të festivaleve për të kultivuar një mjedis gjithëpërfshirës, duke u ofruar grave mundësinë për të formësuar narrativën kinematografike të Kosovës.

Krijimi i hapësirave gjithëpërfshirëse për dialog social

Përtej kinemasë, programi Creative Force përkrah gjithëpërfshirjen shoqërore, duke trajtuar çështje urgjente si demokracinë, të drejtat e njeriut dhe ndryshimet klimatike. Iniciativat e reja, si Kinemaja Sociale, janë të dizajnuara për të angazhuar qytetarët e moshuar në Prizren dhe Prishtinë, duke inkurajuar biseda kuptimplote ndër breza. Nëpërmjet këtyre shfaqjeve dhe diskutimeve, DokuFest-i synon të forcojë lidhjet e komunitetit, të reflektojë mbi vlerat e përbashkëta dhe të nxisë një kuptim më të thellë midis brezave.

Ndikimi në ekonominë dhe industrinë kreative të Kosovës

Ndikimi i DokuFest-it shkon përtej sferës kulturore, duke kontribuar dukshëm në ekonominë e Kosovës. Edicioni i festivalit i vitit 2024 tërhoqi mbi 15,000 pjesëmarrës të drejtpërdrejtë, dhe po aq vizitorë, duke sjellë një shtytje të dukshme ekonomike për bizneset lokale të Prizrenit. I mbështetur nga Sida dhe sponsorë të tjerë të ndryshëm, programi Creative Force forcon rolin e DokuFest-it si një lojtar kyç në ekonominë krijuese të Kosovës, duke nxitur rritjen dhe duke ofruar mundësi të reja për artistët në zhvillim.

Ndërtimi i një të ardhmeje të përballueshme dhe të qëndrueshme për kinemanë e Kosovës

Përkushtimi i DokuFest-it për praktikën e qëndrueshme është një komponent qendrorë e programit Creative Force. Nga zbatimi i iniciativave miqësore për ambientin në festival e deri te nxitja e një kulture të përgjegjësive sociale, qasja e të menduarit për të ardhmen e DokuFest-it jep një shembull për industrinë kreative të Kosovës. Këto veprime nxjerrin në pah rolin e DokuFest-it jo vetëm si një festival, por si një lëvizje e qëndrueshme, e angazhuar shoqërore që promovon ndryshime pozitive përmes kinemasë.

Përmes iniciativave të tij të shumëllojshme, DokuFest-i po transformon peizazhin kulturor të Kosovës, duke krijuar një hapësirë të gjallë, gjithëpërfshirëse dhe të ndërgjegjshme shoqërore për shprehje artistike. Ndërsa programi Creative Force do të shpaloset gjatë pesë viteve të ardhshme, trashëgimia e DokuFest-it do të vazhdojë të frymëzojë, edukojë dhe angazhojë komunitetet e Kosovës, duke hapur rrugë një industrie krijuese të begatë që rezonon si në nivel lokal ashtu edhe atë ndërkombëtar.



STORIES WE TELL

MBËSHTETUR NGA SMART BALKANS (MINISTRIA E JASHTME NORVEGJEZE)
PERIUDHA KOHORE: 2023 – 2025

“STORIES WE TELL”, është një iniciativë e financuar nga “SMART Balkans” për të përdorur mediat audio-vizuale si një urë lidhëse për dialog dhe mirëkuptim në mes të rinjve nga komunitete të ndryshme në Kosovë. Nëpërmjet tre kampeve të ndryshme, të rinj të moshës 18-25 vjeç u mbledhën për të ndarë opinionet dhe përvojat e tyre, me fokus në promovimin e respektit të ndërsjellë dhe luftimin e keqkuptimeve të rrënjësura në media dhe pikëpamje shoqërore.


Për vite me radhë, DokuFest-i ka shfrytëzuar fuqinë e filmit dhe mediave pamore për të frymëzuar kreativitetin dhe për të inkurajuar të menduarit e pavarur tek të rinjtë. Projekti tani e ka shtyrë edhe më tej këtë qasje duke adresuar ndikimin e mediave në botëkuptimet, veçanërisht rreth çështjeve etnike dhe gjinore, të cilat shpesh mbulojnë nga keqinformimi. “STORIES WE TELL” synon të fuqizojë të rinjtë për t’u përballur me këto paragjykime, duke përdorur dialogun si një mjet të fuqishëm për të zbuluar të vërtetat dhe për të nxitur mirëkuptimin. Në një mjedis të panjohur, pjesëmarrësit do ta gjejnë veten të zhytur në diskutime me bashkëmohatarë me prejardhje të ndryshme, duke i sfiduar ata të shohin njëri-tjetrin me çiltërsi dhe jo përmes pikëpamjeve të formuara më parë.

Projekti solli së bashku pothuajse 40 të rinj në tre kampe, të cilët u vendosën në qifte për të punuar në video projekte të shkurtra. Secili çift krijoi video 5-10 minutëshe, duke përdorur artin si një mjet ndërmjetësimi për të kapur perceptimet për njëri-tjetrin. Këto video jo vetëm që shërbejnë si një dëshmi i përvojave të tyre, por janë edhe pjesë e ekspozitave të kuruara që u shfaqën në festival dhe udhëtuan në disa qytete të Kosovës. Duke bashkëpunuar me organizatat lokale të shoqërisë civile, mediat dhe institucionet kulturore, DokuFest-i kishte synim të krijonte hapësira për diskutim të hapur, duke inkurajuar të rinjtë të eksplorojnë informacione dhe perspektiva të reja.

Projekti kishte në fokus të veçantë përfshirjen e grupeve të marginalizuara dhe sigurimin e pjesëmarrjes së gjerë nga e gjithë Kosova. Në fund të kampeve, pjesëmarrësit u intervistuan, duke reflektuar se si pikëpamjet e tyre kanë evoluar mbi përvojën - nga “ajo që dinin më parë” në “atë që dinë tani”.

Këto reflektime, së bashku me video-ekspozitat, kulmuan në një ngjarje publike gjatë DokuFest-it gjatë verës, duke tërhequr vëmendjen e një audience të gjerë për rezultatet e projektit. Ekspozitat u shoqëruan me shfaqje, masterklasa dhe debate, duke i lejuar pjesëmarrësit të takohen përsëri dhe të përmirësojnë edhe më tej mirëkuptimin ndërmjet vete. Kjo qasje gjithëpërfshirëse i mundësoi DokuFest-it të mbledhë njohuri të vlefshme për iniciativat e ardhshme, duke identifikuar çdo boshllëk në përfaqësim dhe duke përmirësuar strategjitë për të zgjeruar ndikimin e punës së tij në angazhimin e të rinjve dhe mirëkuptimin kulturor në Kosovë.

116



117

SHKOLLAT DHE DOKUMENTARËT (NDARJA E NJOHURIVE PËR ZHVILLIMIN SHOQËROR)

MBËSHTETUR NGA NATIONAL ENDOWMENT FOR DEMOCRACY
PERIUDHA KOHORE: 2022 – 2025

Projekti i DokuFest-it “Shkollat dhe Dokumentarët” ka vazhduar punën duke u bazuar mbi sukseset e mëparshme për të fuqizuar mësuesit, studentët dhe institucionet anembanë Kosovës, duke përdorur filmin si një mjet edukativ për adresimin e çështjeve sociale dhe të të drejtave të njeriut. I mbështetur nga National Endowment for Democracy, projekti ka zgjeruar burimet arsimore dhe ka nxitur diskutime kuptimplota brenda klasës.

Edukimi për filmin

Çdo vit, shkolla e filmit “Future is Here” e DokuFest-it ka mbledhur rreth 15 nxënës të shkollave të mesme për të krijuar filma origjinal mbi tema sociale dhe të të drejtave të njeriut, duke i inkurajuar ata të debatojnë për çështje si identiteti, ndryshimet klimatike dhe barazia gjinore. E themeluar në vitin 2013, në shkollën e filmit kanë marrë pjesë 98 nxënës nga 15 komuna të Kosovës, Shqipërisë dhe Serbisë, duke rezultuar në krijimin e 72 filmave dokumentarë. Duke u dhënë të rinjve një platformë për t’u shprehur dhe dialog ndërkulturor, projekti kultivoi një brez tregimtarësh të ndërgjegjshëm shoqëror.

Filmata në arsim

Projekti gjithashtu trajnoi mësuesit në mbarë Kosovën për të integruar filmin dhe multimedial në procesin e mësimit. Duke përdorur Bibliotekën Dixhitale të përmirësuar të Mësuesve, mësuesit patën qasje në një përzgjedhje gjithëpërfshirëse të filmave, videove të shkurtra dhe udhëzuesve të aktiviteteve që përputheshin me Kornizën Kurrikulare të Kosovës. E zhvilluar për të mbështetur klasat me prezencë fizike apo përmes platformave elektronike, biblioteka përmban filma dhe udhëzues të krijuar nga ekspertë të fushës përkatëse për të trajtuar çështje kritike, të tilla si gjuha e urrejtjes dhe keqinformimi, që ndikojnë në mirëkuptimin social të nxënësve.

Në punëtoritë, të cilat mbahen rregullisht që nga viti 2018, janë trajnuar mbi 200 mësues të shkollave të mesme nga rajone të ndryshme të Kosovës. Mësuesit, nga lëndët duke përfshirë gjuhën, studimet sociale dhe madje edhe shkencat, kontribuuan në bibliotekë duke zhvilluar 115 udhëzues filmash për të rritur angazhimin në klasë. Këto punëtori nxitën gjithashtu bashkëpunimet në mes të profesionistëve të arsimit, duke zgjeruar ndikimin e filmit në arsim jo vetëm në Kosovë por edhe në Mal të Zi dhe Shqipëri. Nëpërmjet partneriteve me UnderHill Fest në Mal të Zi dhe KOSH në Shqipëri, programi u zgjerua në nivel rajonal, duke mundësuar shkëmbimin ndërkufitar të njohurive për integrimin e filmave në kontekstet arsimore.

Krijimi i një resursi të qëndrueshëm

Si përgjigje ndaj pandemisë COVID-19, Biblioteka Dixhitale e Mësuesve u ri-dizajnuar për t’iu përshtatur nevojave të mësimit online dhe atij hibrid. Biblioteka u ofroi mësuesve si në shkollat fillore ashtu edhe në ato të mesme materiale të qasshme, duke nxitur të mësuarit përmes filmave që mund të shkarkoheshin dhe shpërndareshin gjerësisht. Mësimet u përgatitën për të sfiduar gjuhën e urrejtjes, për të inkurajuar diskutimet për të drejtat e njeriut dhe për t’u ofruar studentëve mjete të qëndrueshmërisë emocionale.

Udhëzuesit e filmit u bënë një burim i paçmuar, duke u ofruar edukatorëve përmbajtje të strukturuar për përdorim në klasë, nga shfaqjet e filmave e deri te aktivitetet ndërvepruese. Mësuesit vunë në dukje se udhëzuesit promovuan të menduarit kritik dhe angazhimin e nxënësve, duke e bërë mësimin më të efektshëm. Natyra bashkëpunuese e projektit gjithashtu angazhoi drejtoritë e arsimit të Kosovës në 17 komuna, duke vendosur marrëveshje formale për të mbështetur ritjen e programit. Këtë e ka pranuar edhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit e cila ka nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me DokuFest-in, ndërsa Agjencia Shtetërore për Akreditim ka akredituar DokuFest-in për të ofruar trajnime për mësuesit e shkollave të mesme për përdorimin e Bibliotekës Dixhitale të Mësuesve.

Duke zgjeruar shtrirjen e tij dhe duke pasuruar burimet arsimore, projekti i DokuFest-it “Shkollat dhe Dokumentarët” është dëshmuar se është një iniciativë transformuese, duke nxitur mendimin kritik, dialogun kulturor dhe një mjedis mësuesor gjithëpërfshirës në mbarë Kosovën dhe më gjerë.

 NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY
SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD



DOKU
EST

INOVACIONI DIGJITAL I FILMIT DHE TRANSFORMIMI KULTUROR

MBËSHTETUR NGA DEUTSCHE GESELLSCHAFT FÜR INTERNATIONALE ZUSAMMENARBEIT (GIZ) GMBH
PERIUDHA KOHORE: 2024 – 2025

DokuFest-i ka lansuar projektin “Inovacioni i filmit dixhital dhe transformimi kulturor” për të fuqizuar kineastët e ardhshëm të Kosovës.

DokuFest-i, ka nisur një iniciativë të re ambicioze: Projektin e Inovacionit dhe Transformimit Kulturor të Filmit Dixhital (D:Fict). I dizajnuar në partneritet me GIZ GmbH, D:Fict synon të fuqizojë gjeneratën e ardhshme të tregimtarëve dhe kineastëve dixhital të Kosovës. Ky projekt zhvillohet në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren, një qendër plot gjallëri për bashkëpunim ndërmjet kompanive vendore dhe ndërkombëtare, programeve të trajnimit profesional, institucioneve akademike, agjencive qeveritare, OJQ-ve dhe sektorit kulturor.

Ndërsa aftësimi dixhital dhe aftësitë krijuese bëhen thelbësore, D:Fict i përgjigjet një nevoje në rritje duke ofruar një program njëvjeçar, me zgjerim të mundshëm mbi pesë vjet, i krijuar për të formësuar talentët e rinj në prodhimin dixhital dhe të filmit. Përmes një serie punëtorish dhe projektesh praktike, iniciativa do t'i trajnojë të rinjtë e moshës 12 deri në 18 vjeç në krijimin e përmbajtjes themelore dhe të avancuar dhe krijimin e filmave, duke vendosur skenën për një valë të re të krijuesve dixhital në Kosovë.

Programi mbështetet në dy iniciativa të DokuFest-it: Linjën e Aftësive Dixhitale dhe Linjën e Filmit Dixhital. Këto platforma ofrojnë një përvojë gjithëpërfshirëse të të mësuarit, duke filluar nga aftësimi elementar audiovizual e deri te prodhimi i avancuar i filmit dixhital. Ajo që e bën D:Fict të dallohet nuk është vetëm përqendrimi i tij në aftësitë teknike, por misioni i tij për të frymëzuar të rinjtë që të përdorin kinemanë si një mjet për ndryshime sociale.

D:Fict është në përputhje me Agjendën Dixhitale të Kosovës 2030, duke adresuar boshllëqet në edukimin dixhital dhe ndërgjegjësimin për sigurinë kibernetike, duke kontribuar gjithashtu në një fuqi punëtore të aftë në këtë fushë. Duke u përqendruar në sektorët kulturorë dhe krijues, projekti mbështet synimet më të gjera të transformimit dixhital të Kosovës.

Vetëm në vitin e tij të parë, D:Fict synon të pajisë së paku 200 të rinj me aftësi thelbësore dixhitale dhe të bërjes së filmit, duke prodhuar përmbajtje që u japin zë dhe perspektiva unike rinisë së Kosovës. Përtej zhvillimit të aftësive individuale, projekti gjithashtu forcon pozicionin e ITP-së si një qendër rajonale për Industrinë Kreative dhe Kulturore.

Një faktor vendimtar në suksesin e D:Fict është rrjeti i tij i bashkëpunimeve me organizatat lokale dhe ndërkombëtare, i cili siguron që pjesëmarrësit të marrin udhëzime të ekspertëve nga profesionistët të industrisë dhe qasje në burime të vlefshme.

Nëpërmjet D:Fict, DokuLab-i vazhdon angazhimin e tij për zhvillim social përmes filmit. Ky projekt qëndron si një model i inovacionit në arsimin dixhital, duke i pajisur të rinjtë e Kosovës me aftësi dhe besim për të udhëhequr rrugën në industrinë kreative ndërsa ata lëvizin drejt një të ardhmeje dixhitale.



KOSOVO INNOVATION PROJEKTI I TRANSFORMIMIT SHOQËROR +

MBËSHTETUR NGA AMBASADA HOLANDEZE
PERIUDHA KOHORE: 2023 – 2024

Projekti Kosovo Innovation Social Transformation Plus (KIST+), i udhëhequr nga DokuFest-i dhe Qendra Kosovare për Arsim (KEC), kishte synim të nxiste ndryshimet sociale dhe inovacionet në mbarë Kosovën përmes arsimit dhe angazhimit të komunitetit. Duke mbuluar një periudhë kohore nga qershori 2023 deri në maj 2024, KIST+ u përqendrua në pajisjen e komuniteteve lokale me edukim në fushën e mediave dixhitale dhe adresimin e çështjeve si përandalimi i radikalizmit dhe marrëdhëniet ndëretnike.

KIST+ bashkëpunoi me shkollat dhe OJQ-të në 12 komuna në Kosovë, duke krijuar një bazë për një bashkëpunim afatgjatë dhe me ndikim. Faza e hershme e projektit përfshiu zgjedhjen e përfaqësuesve të komunitetit dhe rinovimin e anëtarësimeve në klubet e shkollave. DokuFest-i dhe KEC-i organizuan një takim njohës për të vendosur kontakt me organizatat formale dhe joformale të komunitetit. Pas sfidave fillestare në sigurimin e pjesëmarrjes së OJQ-ve, ekipi i projektit arriti të krijojë partneritete që vendosën një ton bashkëpunimi për të gjithë projektin.

Gjatë gjithë vitit, projekti organizoi një program shkollor veror, "DokuKids", i cili ofroi trajnime mbi tema që varionin nga lajmet e rreme dhe algoritmet e mediave sociale e deri tek animacioni stop-motion. Mbi 100 nxënës dhe përfaqësues të komunitetit morën pjesë në këtë shkollë verore, duke fituar aftësi në edukimin mediatik dhe bërjen e filmave. Pjesëmarrësit krijuan gjithashtu 12 animacione stop-motion, duke shfaqur kreativitetin e tyre ndërsa eksploronin tema të rëndësishme shoqërore.

Për të mbështetur edukimin për çështje kritike, KIST+ zgjodhi filma për shfaqje në komunitet, duke përfshirë vepra që trajtojnë radikalizmin, edukimin dixhital dhe marrëdhëniet ndëretnike. Mësuesit u trajnuan dhe zhvilluan udhëzues filmash për të lehtësuar këto shfaqje. Mësuesit dhe nxënësit u angazhuan në diskutime pas shikimit të filmave, duke nxitur një njohje më të thellë të këtyre temave në një mjedis bashkëpunues.

Tregimi me interes njerëzor u bë gjithashtu një pjesë thelbësore e programit KIST+. Studentët prodhuan 11 filma të shkurtër me interes njerëzor, duke eksploruar tema si integrimi social dhe edukimi mediatik. Duke punuar ngushtë me anëtarët e komunitetit dhe klubet e shkollave, këta regjisorë të rinj krijuan rrëfime që vinin në pah temat e projektit, duke përfunduar rëndësinë e kohezionit social dhe përgjegjësisë mediatike.

Përveç kësaj, KIST+ solli Sfidën e Transformimit Social Dixhital, duke ofruar grante të vogla për iniciativat me bazë në shkollë që trajtonin marrëdhëniet ndëretnike dhe kundërshtonin gjuhën e urrejtjes. Sfida kulmoi me një garë miqësore, me shkollat të njohura për kreativitetin dhe përkushtimin e tyre ndaj ndryshimeve pozitive sociale.

KIST+ përfundoi me një ngjarje finale me ekspozita dhe shfaqje projektesh, duke festuar arritjet e nxënësve, mësuesve dhe bashkëpunëtorëve të komunitetit. Duke nxitur arsimin dixhital, të menduarit kritik dhe frymën e bashkëpunimit, projekti KIST+ ka lënë një ndikim të qëndrueshëm në peizazhin arsimor dhe social të Kosovës. Përmes këtyre përpjekjeve, DokuFest-i dhe KEC-i demonstruan potencialin e edukimit dhe të tregimit për të fuqizuar komunitetet dhe për të ndërtuar një shoqëri më të ndërlidhur.

PROJEKTI YESS PËR TREGIM DHE KRIJIMTARI FILMIKE

MBËSHKETUR NGA UNICEF
PERIUDHA KOHORE: 2024 – 2025

DokuFest-i, në partneritet me UNICEF-in, po fillon me një seri të re të fuqishme iniciativash rinore që shfrytëzojnë artin e tregimit dhe të krijimit të filmave për të nxitur ndryshime sociale. Këto projekte synojnë t'u ofrojnë të rinjve mjete krijuese për t'u shprehur, për t'u angazhuar me komunitetet e tyre dhe për të trajtuar çështje urgjente sociale.

Në qendër të kësaj iniciative është projekti për Fuqizimin e Rinisë për Tregim dhe Ndryshim Social (YESS), i cili do të mbështesë 250 studentë nga 11 komuna të Kosovës përmes trajnimeve praktike në tregim, fotografi dhe kinematografi. Gjatë punëtorive dy-ditore të organizuara në nivel lokal, nxënësit do të fitojnë aftësi praktike në tregimin vizual të tregimeve, të ndjekura nga trajnimi në redaktim pas prodhimit. Me mbështetjen e vazhdueshme nga mentorët e DokuFest-it, këta krijues të rinj do të prodhojnë 10 filma të shkurtër tërheqës që pasqyrojnë histori të interesit njerëzor nga komunitetet e tyre.

Nga tetori 2024 deri në prill 2025, projekti do të mbështesë studentët jo vetëm të eksplorojnë krijimtarinë e tyre, por edhe të bëhen zëra aktivë për ndryshim brenda komuniteteve të tyre. Përmes këtyre filmave, ata do të kenë mundësinë të trajtojnë çështje të tilla si barazia sociale, të drejtat e njeriut dhe përgjegjësia mjedisore, duke sjellë perspektiva të reja në peizazhin social të Kosovës.

Duke u fokusuar në angazhimin e të rinjve dhe shprehjen kreative, DokuFest-i dhe UNICEF-i synojnë të frymëzojnë një brez të ri kineastësh dhe tregimtarësh të ndërgjegjshëm shoqëror. Këto projekte janë pjesë e misionit më të gjerë të DokuFest-it për të ushqyer talentin e ri të Kosovës, për të rrënjësuar besimin dhe për të nxitur një komunitet të artistëve të rinj që kontribuojnë në mënyrë domethënëse në jetën kulturore dhe qytetare. Përmes YESS-it, të rinjtë e Kosovës do të jenë të gatshëm të bëjnë një ndikim të qëndrueshëm, duke përdorur zërin dhe talentin e tyre për të formuar një të ardhme më të ndritshme për komunitetet e tyre.

CONNECTING DOTS: EKSPLORIMI I TRASHËGIMISË SË PËRBASHKËT TË FILMIT

MBËSHTETUR NGA PROJEKTI “KULTURA DHE KREATIVITETI PËR BALLKANIN PERËNDIMOR” (CC4WBS) PROJECT PERIUDHA KOHORE: 2023 – 2020

DokuFest-i, me mbështetjen e Këshillit Britanik, zbatoi “Connecting Dots: Exploring Shared Film Heritage”, një projekt i dedikuar për ruajtjen dhe ri-interpretimin e trashëgimisë filmike të Kosovës brenda kontekstit më të gjerë të kinemasë së Ballkanit Perëndimor. Gjatë një periudhe nga tetori 2023 deri në shtator 2024, iniciativa do të mbushë boshllëqet kulturore dhe historike duke u thelluar në të kaluarën kinematografike të rajonit dhe duke shqyrtuar se si tregimet e Kosovës janë thurur në kinemanë e epokës jugosllave dhe bashkëkohore.

Projekti u shpaloj përmes një sërë aktivitetesh kërkimore të mbajtura në Kosovë dhe Serbi. Studiuesit hulumtuan tema si ndikimi social i kinemave historike në Prizren dhe roli i kineasteve femra në Kosovën post-jugosllave. Në Prizren, studiueset Ivona Djurić dhe Radisa Cvetkovic hulumtuan mbi historinë e kinemasë lokale, duke rezultuar në krijimin e një fanzine¹ dhe një eseje dokumentare. Fanzina e Djurić-it, Vala e Re e Zërave Femërorë në Kinematografinë e Kosovës, nderon femrat regjisore kosovare që kanë riformësuar narrativat mbi luftën, gjininë dhe transformimin social, ndërsa filmi i Cvetkoviqit, Kino Memories, dokumenton lidhjen e komunitetit me kinematë ikonike siç ishte Kino Bistrica.

Në Beograd studiuesit Bengi Muzbeg dhe Tefik Rada kryen kërkime arkivore, duke zbuluar filma dhe botime të epokës jugosllave që nxjerrin në pah kontributet kinematografike të Kosovës. Gjetjet e tyre po organizohen në një platformë dixhitale, të qasshme përmes DokuFest-it, për të siguruar një angazhim të gjerë dhe të vazhdueshëm me këtë trashëgimi unike. Platforma online, e pasuruar me filma të rrallë, dokumente dhe analiza akademike, shërben si një burim për studime në të ardhmen dhe ruajtjen kulturore.

DokuFest-i gjithashtu tërhoqi vëmendjen e publikut përmes shfaqjeve, diskutimeve dhe ekspozitave si në DokuFest ashtu edhe në festivalin Beldocs. Pikat kryesore përfshinë ekspozitën “Connecting Dots”, me materiale arkivore, dhe një sesion DokuTalk mbi dimensionet etike të arkivimit, i moderuar nga figura të shquara rajonale. Ngjarjet në terren të projektit tërhoqën mbi 700 pjesëmarrës, duke nxitur dialogun mbi historinë komplekse kinematografike të rajonit dhe rolet e kujtesës dhe ruajtjes.

Përmes këtij projekti, DokuFest-i jo vetëm që ruan trashëgiminë filmike të Kosovës, por gjithashtu nxit shkëmbimin dhe bashkëpunimin kulturor, duke krijuar një bazë për dialog të vazhdueshëm dhe mirëkuptim të përbashkët në të gjithë Ballkanin Perëndimor. “Connecting Dots” është një shembull i fuqishëm se si kinemaja mund të lidhë historinë dhe të nxisë lidhje që kapërcejnë kufijtë dhe brezat. *Të gjitha punimet janë paraqitur në faqen e internetit të projektit: dots.dokufest.com*

BREAKING BORDERS

MBËSHKETUR NGA KËSHILLI BRITANIK
PERIUDHA KOHORE: 2024 – 2025

DokuFest-i, në bashkëpunim me Institutin Skocez të Dokumentarit (SDI), po lançon Breaking Borders, një projekt inovativ për të sjellë së bashku kineastët e rinj nga Kosova dhe Mbretëria e Bashkuar. Kjo iniciativë, e krijuar për të promovuar mirëkuptimin ndërkulturor dhe bashkëpunimin kreativ, do të zhvillohet në Kosovë, duke ofruar një aktivitet unik për ish-studentët e SDI's Bridging the Gap dhe Future is Here të DokuFest-it. Së bashku, ekipet synojnë të përdorin fuqinë e krijimit të filmave dokumentarë për të eksploruar temën e ri-imagjinimit të bashkëpunimit në një botë të polarizuar.

Projekti fillon me një fazë të strukturuar të angazhimit kulturor, ku pjesëmarrësit do të përfshihen në aktivitete që synojnë të thellojnë të kuptuarit e tyre për historinë e njëri-tjetrit. Kjo fazë themelore - që përfshin shfaqje filmash, diskutime të moderuara dhe seminare - krijon një bazë të përbashkët respekti dhe ndjeshmërie, e cila bëhet një katalizator për një sinergji krijuese.

Pas këtij shkëmbimi kulturor, projekti e zhvendos fokusin në realizimin e filmave në praktikë. Gjatë angazhimit në punë praktike, kineastët do të bashkëpunojnë në ekipe ndërkulturore për të zhvilluar dhe prodhuar dokumentarë të shkurtër. Të udhëhequr nga mentorë me përvojë, ata do të eksplorojnë zhvillimin narrativ, aftësitë teknike dhe eksplorimin tematik, me Kosovën si kanavacën e tyre krijuese. Qëllimi është të krijohen filma që jo vetëm pasqyrojnë përvojat e përbashkëta të kineastëve, por gjithashtu veprojnë si një dokumentar i vetë procesit të bashkëpunimit, duke theksuar se si perspektivat e ndryshme mund të bashkohen për të prodhuar narrativa me ndikim.

Ky partneritet është veçanërisht i rëndësishëm për DokuFest-in, i njohur për përkushtimin e tij ndaj ndikimit social përmes kinemasë, dhe SDI, i njohur për nxitjen e talenteve të pavarur në fushën e dokumentareve. Kjo aleancë përfaqëson një shkrirje të platformës së krijuar të DokuFest-it në Evropën Juglindore dhe ekspertizës së SDI-së në trajnimin në fushën e dokumentareve, duke shënuar një qasje të re ndaj bashkëpunimit ndërkombëtar. Duke i pozicionuar kineastët si agjentë të ndryshimit shoqëror, projekti inkurajon pjesëmarrësit të përdorin artin e tyre për të trajtuar çështje të rëndësishme sociale dhe politike.

Breaking Borders shkon përtej ndarjes tradicionale të burimeve, duke synuar në vend të kësaj të vendosë një standard të ri për bashkëpunime në fushën e dokumentareve duke integruar shkëmbimin kulturor dhe profesional. Si pjesë e angazhimit të DokuFest-it për gjithëpërfshirje, ky angazhim me punë praktike ofron një mundësi për pjesëmarrësit që të krijojnë vepra që jehojnë globalisht, duke demonstruar fuqinë transformuese të kinemasë për të kapërcyer ndarjet dhe për të frymëzuar ndryshimin.



GENERAL SUPPORT

MBËSHTETUR NGA ROCKEFELLER BROTHERS FUND

PERIUDHA KOHORE: 2024 – 2026

Nga viti 2024 deri në vitin 2026, Mbështetja e Përgjithshme nga Fondi Rockefeller Brothers (RBF) ka qenë thelbësore për kuadrin tonë operacional.

Kjo mbështetje ka qenë vendimtare në mbulimin e shpenzimeve ditore operative, duke na ofruar fleksibilitet për të shpërndarë në mënyrë strategjike burimet drejt misionit tonë kryesor dhe prioritetëve organizative.

Stabiliteti financiar dhe fleksibiliteti i ofruar nga financimi i RBF-së kanë qenë jetike në përballimin e kostove thelbësore operative, duke siguruar qëndrueshmërinë e punës sonë të përqendruar tek misioni. Kjo mbështetje i mundësoi organizatës sonë të fokusohet në ofrimin e programeve me ndikim pa kufizimet e zakonshme të ndërlidhura me financat.

FERTILE GROUND

MBËSHTETUR NGA PRINCE CLAUS FUND

PERIUDHA KOHORE: 2023 – 2025

DokuFest-i e ka shtrirë “Fertile Ground” edhe në vitin 2024, një projekt ky i mbështetur nga Fondi Prince Claus. Kjo nismë ndërthur angazhimin në punë praktike të artistëve me shkollën e filmit “Future is Here” dhe projektin “Connecting Dots”, duke krijuar një mjedis dinamik të bashkëpunimit artistik dhe rritjes arsimore.

Në vitin 2024, dy përfitues të SEED nga Fondi Prince Claus përfunduan angazhimin e tyre praktik gjatë festivalit DokuFest, duke kontribuar aktivisht në programet dhe ekspozitat e zhvillimit të talenteve. Përfshirja e tyre i shtoi vlerë ofertës edukative të festivalit, duke forcuar lidhjen midis artistëve në zhvillim dhe komunitetit të DokuFest-it. Duke parë nga e ardhmja, DokuFest-i do të mirëpresë përfitues shtesë të SEED në programin e angazhimit në punë praktike në vitin 2025, duke e rritur më tej këtë bashkëpunim të vlefshëm.

“Fertile Ground” vë në pah përkushtimin e DokuFest-it për partneritete të qëndrueshme dhe shkëmbime ndërkulturore, duke avancuar ndjeshëm tregimin e bazuar ne ngjarje reale në Ballkanin Perëndimor. Është një dëshmi e rolit të DokuFest-it në edukimin e brezit të ardhshëm të artistëve dhe tregimtarëve.